UDHEHEQUR NGA

# VLORA MARINA

ERA

SHQIPËRI





# FRYMËZUAR NGA

# DETI





# UDHËHEQUR NGA
# ERA

Ne shijojmë jetën çdo ditë!

Ju mund të jeni vazhdimisht në kërkim të aventurave, por këtu do të gjeni atë çfarë keni kërkuar deri tani. Ky është vendi ku të gjitha shqetësimet treten në puhizën e ngrohtë të detit duke ia lënë vendin kujtimeve të bukura. Është një ftesë për të ngritur velat drejt lundrimeve të pafundme, për të pasur përvoja unike, perspektiva dhe mundësi të reja.

Ju do të jetoni dhe do të qetësoheni, por mbi të gjitha do të shijoni me të gjitha shqisat tuaja një vend, tek i cili do të kuptoni vlerën e jetës, lidhjet njerëzore, përvojat, shijet e larmishme dhe magjepsjet shumëdimensionale.

Janë këto ndjesi që të bëjnë të ndihesh i plotë mes plazheve të mrekullueshme, natyrës fantastike përreth, zbulimit të historisë dhe kulturës. Të gjitha bashkohen e shkrihen në një mozaik të përsosur; e shkuara, e tashmja, e ardhmja, tradita dhe modernia.

Tek Vlora Marina gjithmonë ka diçka të re për të zbuluar ku do të ndiheni njëherësh si në shtëpi në çdo kohë. Frymëzuar nga deti, udhëhequr nga era! Ju ftojmë t'i lini çastet e bukura të vijnë tek ju.



# Zbulo Shqipërinë

Eksploroni një vend të mrekullueshëm, i cili shtrihet mes brigjeve ranore të detit Adriatik dhe brigjeve shkëmbore të detit Jon. Një destinacion, ku klima mesdhetare do ta bëjë më të bukur qëndrimin tuaj në çdo kohë që do të vendosni ta vizitoni.

Me anëtarësimin në zonën Shengen dhe potencialin si një vend anëtar i BE-së, Shqipëria paraqet mundësi të pafundme udhëtimesh nga jugu në veri, eksplorim dhe mbi të gjitha mundësi të shkëlqyera investimi. Me një pozicion gjeografik sa strategjik po aq sa edhe si një thesar i fshehur, Shqipëria ofron një eksperiencë të veçantë, duke ju dhuruar në çdo çast ndjesinë se i përkisni kësaj toke.

Ju ftojmë të na bashkoheni në eksplorimin e bukurive të vendit tonë, zbulimin e trashëgimisë së gjallë kulturore dhe mikpritjen, që e identifikon më shumë se gjithçka tjetër Shqipërinë. Jemi të lumtur të ndajmë me ju gjërat që na veçojnë dhe na bëjnë një destinacion vërtetë të jashtëzakonshëm në zemër të Mesdheut.

**+20,5% kontributi i turizmit në ekonomi**

**300 ditë me diell**

**2.8 milionë banorë dhe 3 milionë të tjerë në diasporë**

**450 km vijë bregdetare**

**Iso-polifonia, pasuri e jashtëzakonshme që mbrohet nga UNESCO, si Pasuri Botërore e Trashëgimisë Kulturore Jomateriale**

**Kuzhina tipike mesdhetare**

**Bregdet dhe mal, të shkrira në një**

**Sipërfaqja totale e vendit, 28.748 km$^2$**

**Origjina, pasardhës të ilirëve**


Gjiri i Gramës



Vlorë

# Thesari i fshehur në Mesdhe

### Një vend i paeksploruar

Shqipëria është një vend i pasur me trashëgimi kulturore dhe histori unike, e mirënjohur për kuzhinën e saj plot shije, natyrën e bukur dhe plazhet e shumta natyrore ku dora e njeriut ende nuk ka ndërhyrë. Vendi po zhvillohet çdo ditë me plot mundësi të reja, por është ende i paeksploruar. Si një vend kandidat për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, Shqipëria është vendi ideal për të ndërtuar të ardhmen që gjithmonë keni imagjinuar.



## Klimë dhe peizazh i pakrahasueshëm

Shqipëria ka një klimë mesdhetare ku mbizotëron moti i mirë me diell gjatë 300 ditëve të vitit. Përgjatë brigjeve të Adriatikut dhe Jonit dimri është i butë dhe vera jo shumë e nxehtë, duke ofruar mundësi të shumta për aktivitete në det dhe mal. Kjo klimë krijon kushtet e duhura për eksplorimin e vendit 360 gradë në çdo ditë të vitit.

# Një histori unike dhe trashëgimi e UNESCO-S për t'u eksploruar



## QYTETI MUZE I BERATIT

I shpallur qytet muze në vitin 1961 dhe një nga vendet e futura në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në vitin 2008, Berati dhe monumentet e tij të shumta janë një dëshmi e gjallë e trashëgimisë unike artistike, kulturore dhe historike të Shqipërisë.

## PARKU KOMBËTAR I BUTRINTIT

Qyteti antik i Butrintit, përbën një kombinim shumë të rrallë të arkeologjisë dhe natyrës. Ndonëse punimet arkeologjike asnjëherë nuk kanë përfunduar, mendohet se ajo që shohim sot mund të jetë me shumë mundësi vetëm një e pesta e asaj që ndodhet nëntokë. Butrinti sot është një kompleks arkitektonik me 15 zona të periudhave të ndryshme, nga shekulli IV para Krishtit deri në shekullin XVI pas Krishtit. Mbretër, pushtues, princër, mendimtarë, arkeologë dhe historianë kanë gjetur në rrënojat e qytetit një simetri të historisë së njerëzimit. Parku Kombëtar i Butrintit është listuar si pasuri e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s në vitin 1992.





# QYTETI MUZE I GJIROKASTRËS

I kthyer në një atraksion turistik nga shteti shqiptar në vitin 1961 si dhe i listuar si vend i Trashëgimisë Botërore të Njerëzimit nga UNESCO, në vitin 2005. Gjirokastra është e vendosur në një kodër dhe përfaqëson një trashëgimi të pasur të kulturës dhe traditës. Me pamjen nga lugina e Drinos, Gjirokastra dhe rrugët e saj të ngushta janë dëshmi e jetës gjatë shekujve XIV-XIX.

# ISO POLIFONIA

Që nga viti 2005 "Isopolifonia popullore shqiptare" iu shtua listës së "Kryeveprave të trashëgimisë jomateriale të njerëzimit" të mbrojtura nga UNESCO, si një trashëgimi unike, e cila nuk gjendet askund tjetër në botë. Shpirti i një identiteti dhe pasurie unike shpirtërore, polifonia qëndron si një ylber i pakapshëm i historisë së popullit tonë.





# XHUBLETA SHQIPTARE

E futur së fundmi në mbrojtje nga UNESCO, Xhubleta është një veshje e punuar tërësisht me dorë, e cila vishej nga gratë dhe vajzat malësore në veri të vendit, e karakterizuar nga forma e saj e valëzuar e ziles. Xhubleta dikur përdorej në jetën e përditshme, duke treguar statusin social dhe ekonomik të mbajtësit.

LËRI MOMENTET E BUKURA

TË VIJNË

# SI VALËT E DETIT



# Përse të investosh në Shqipëri!

Investimi në Shqipëri mund të ofrojë një sërë përfitimesh dhe mundësish.

1. **Integrimi në BE:** Aspiratat e Shqipërisë për t'u bërë pjesë e Bashkimit Evropian kanë ndikim të mirë në sektorin e pasurive të paluajtshme. Anëtarësimi në BE mund të tërheqë më shumë investime të huaja, të nxisë rritjen ekonomike dhe të rrisë vlerën e pasurive të paluajtshme në plan afatgjatë.

2. **Vendndodhja Strategjike:** Shqipëria ka një vendndodhje të mirë gjeografike dhe akses në tregjet kryesore të Evropës dhe Ballkanit. Afërsia e saj me Bashkimin Evropian ofron mundësi të shumta në industri të ndryshme.

3. **Rritja Ekonomike:** Shqipëria ka shënuar rritje të qëndrueshme ekonomike në vitet e fundit, me prirje pozitive në rritjen e PBB-së.

4. **Zhvillimi i Infrastrukturës:** Përmirësimi i infrastrukturës ka ndikim pozitiv në kërkesën dhe vlerën e pasurive të paluajtshme.

- Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës dhe Tuneli i Llogarasë
- Bypass i Vlorës
- Rruga Sarandë - Himarë
- Bypass i Fierit
- Aeroporti Ndërkombëtar i Kukësit
- Hekurudha Tiranë-Durrës-Prishtinë



5. **Bumi Turistik:** Shqipëria po përjeton një rritje të konsiderueshme të turizmit, duke mirëpritur një numër gjithnjë e më të madh vizitorësh që eksplorojnë bregdetin, vendet historike dhe peizazhet natyrore. Kjo rritje e turizmit krijon mundësi investimi në qiradhënie për pushime, hotele dhe pasuri të tjera të orientuara për turistët. Kohët e fundit Shqipëria është konsideruar si një vend me potenciale të mëdha nga brandet ndërkombëtare të hoteleve me 5 yje.

6. **Kosto të përballueshme:** Krahasuar me vendet e tjera evropiane, kostoja e jetesës dhe pasurive të paluajtshme në Shqipëri është relativisht e përballueshme. Kjo është një mundësi për individët që po mendojnë të investojnë në pasuri me kosto më të ulëta krahasuar me tregjet e tjera të huaja. Taksat mbi pronën janë nga më të ulëtat në BE dhe rajon dhe nuk ka taksa shtesë për shtëpi të dyta apo shtëpi pushimi.

7. **Mundësitë e të Ardhurave nga Qiraja:** Duke qenë se ka rritje të kërkesës për strehim dhe hapësira biznesi, dhënia e pronave me qira mund të sjellë të ardhura të qëndrueshme. Bazuar në përvojën e deritanishme të sektorit të pasurive të paluajtshme dhe sektorit të turizmit, çmimet e pronave në Shqipëri po rriten. Ky fakt, si dhe zhvillimi konstant në këtë fushë sigurojnë një kthim të shpejtë të investimit.

# VLORA, NJË QYTET I VEÇANTË

Vlora është një prej qyteteve më të vjetra të Shqipërisë. Në lashtësi ajo njihej me emrin Aulona, ndërsa referencat historike tregojnë se Ptolemeu ishte ai që e ka përmendur qytetin për herë të parë. Vlora është një qytet me shumë histori dhe gjithashtu është vendi ku u ngrit Flamuri i Pavarësisë kur Shqipëria shpalli mëhvetësinë nga Perandoria Otomane në vitin 1912, pas 5 shekujve nën sundimin otoman. Midis brigjeve të Adriatikut dhe Jonit, Vlora qëndron si një destinacion tërheqës, i pasur me tradita dhe i njohur për mikpritjen dhe vitalitetin e saj.

Me bukurinë dhe historinë autentike, Vlora është një vend unik për të pushuar, për t'u përhumbur në peizazhet e mrekullueshme të natyrës dhe për të shijuar më të mirën e kuzhinës mesdhetare. Vitet e fundit, qyteti ka përjetuar investime transformuese në infrastrukturë, si nga qeveria ashtu edhe nga investitorët e huaj.


Vlorë, Shqipëri




# DISTANCAT:

| | |
|---|---|
| Shkodra | 3orë 15min |
| Tirana | 2orë 15min |
| Durrës | 1orë 35min |
| Saranda | 2orë 15min |

# PIKA TURISTIKE:

| | |
|---|---|
| Manastiri i Zvërnecit | 20min |
| Muzeu i Pavarësisë | 2min |
| Gadishulli i Karaburunit | 1orë 20min |

# PLAZHE UNIKE:

| | |
|---|---|
| Gjiri i Gramës | 1orë |
| Plazhi i Porto Palermos | 1orë 20min |
| Plazhi i Palasës | 1orë 20min |
| Plazhi i Dhërmiut | 1orë 20min |



VARRI
I ISMAIL QEMALIT
MUZEU
HISTORIK
MONUMENTI
I PAVARËSISË
QYTETI I VJETËR
XHAMIA
E MURADIES
STADIUMI
FLAMURTARI
VLORA MARINA
MUZEU KOMBËTAR
I PAVARËSISË
LUNGOMARE
KALAJA
E KANINËS
KALAJA
E GJON BOÇARIT
KALAJA
E PORTO
PALERMOS
KISHA
E MARMIROIT


ICELAND
NORWAY
SWEDEN
FINLAND
RUSSIAN FEDERATION
ESTONIA
LATVIA
LATGALE
DENMARK
LITHUANIA
IRELAND
UNITED KINGDOM
BELARUS
WARSAW
2 hours
LONDON
3 hours
NETHERLANDS
POLAND
BRUSSELS
2.5 hours
GERMANY
BELGIUM
UKRAINE
CZECH REPUBLIC
FRANKFURT
2 hours
SLOVAKIA
PARIS
2.5 hours
VIENNA
1.5 hours
BUDAPEST
1.5 hours
MOLDOVA
AUSTRIA
HUNGARY
GENEVA
2 hours
SWITZERLAND
FRANCE
SLOVENIA
CROATIA
ROMANIA
MILAN
1.5 hours
ITALY
SERBIA
MONACO
ANDORRA
BULGARIA
ROME
1.2 hours
ISTANBUL
1.5 hours
PORTUGAL
SPAIN
ALBANIA
TURKEY
GREECE
ATHENS
1 hour




# DISTANCAT E FLUTURIMIT

| | | | |
|---|---|---|---|
| Londër | 3 Orë | Stamboll | 1.5 Orë |
| Paris | 2.5 Orë | Vienë | 1.5 Orë |
| Bruksel | 2.5 Orë | Budapest | 1.5 Orë |
| Frankfurt | 2 Orë | Milan | 1.5 Orë |
| Gjenevë | 2 Orë | Romë | 1.2 Orë |
| Varshavë | 2 Orë | Athinë | 1 Orë |

# DISTANCAT DETARE

| | | |
|---|---|---|
| Durrës | Alb | 51 NM; N |
| Korfuz | Gre | 54 NM; SSE |
| Brindizi | Ita | 71 NM; W |
| Bari | Ita | 126 NM; WNW |
| Split | Kro | 228 NM; NW |
| Athinë | Gre | 247 NM; SE |



# Mirë se vini
# në Vlora Marina

# Një destinacion i Klasit Botëror

Një zhvillim urban miks, në të cilin do të gjeni gjithçka që keni imagjinuar dhe shumë më tepër. E vendosur në qendër të qytetit, Vlora Marina ofron një numër të limituar të apartamenteve Premium dhe atyre të branduara me pamje ekskluzive nga deti.

Marinë e klasit botëror - e para në Shqipëri me +400 vende ankorimi për jahte dhe mega-jahte gjatë gjithë vitit.

Shëtitorja e Vlora Marina shtrihet buzë detit dhe mund të konsiderohet si një nga më të gjatat, pasi lidhet edhe me shëtitoren pranë pyllit të Sodës.

Hotelet në Vlora Marina janë të standardeve ndërkombëtare. Dy hotelet me 4* dhe 5* janë pjesë e rrjetit ndërkombëtar të hoteleve të pranishëm në mbi 139 vende me mbi 8,700 struktura akomodimi.

Rrjeti prestigjioz Marriott sjell hotelin e parë me 5-yje Vlora Marriott Hotel në bregdetin shqiptar, duke ofruar ekselencën në shërbim dhe standardet premium. Një tjetër hotel brand me 4 yje do të jetë pjesë e Vlora Marina gjithashtu.

Studioja prestigjioze belge e projektimit, XDGA – Xaveer De Geyter Architects- ka sjellë në jetë këtë projekt unik, duke vendosur standarde të reja për atë që njihet si “jetesë premium”.



# Masterplan




1 Rezidencë shumëfunksionale
2 Njësi tregtare dhe shërbime
3 Hoteli me 5* Vlora Marriott Hotel, shërbime, rezidenca
4 Marina
5 Infrastrukturë rrugore
6 Parqe rekreative
7 Shëtitore
8 Hapësira të gjelbërta
9 Plaza
10 Plazhe private dhe publike
11 Hapësira parkimi publike
12 Hotel me 4 yje
13 Klubi i jahteve, shërbimet e Marinës, apartamente elitare, kazino, qendër Wellness,




# Kur mendohet të përfundojnë punimet?

2027 D4

2028 B2, B3, B4, C5

2029 A1, C2, C3, C4, D3

2030 B1, C1

2031 A2, A3, D2




Fisharia

Një projekt bashkëkohor që ruan vlerat mesdhetare, të cilat lidhin traditën me modernen, të shkuarën me të tashmen. Një përvojë unike që të kujton se çfarë ka vërtetë rëndësi në jetë; lidhjet njerëzore dhe dëshira për të bukurën.





# Një botë me Privilegje

Vlora Marina është një zhvillim urban miks, me apartamente premium me pamje nga deti dhe një shëtitore fantastike buzë saj. Një vend i veçantë, ku mund të përjetoni emocione pa limit.

- Apartamente premium me pamje nga deti
- Numër i kufizuar apartamentesh për kat
- Veranda private dhe dritë natyrale
- Shërbime mirëmbajtje gjatë gjithë vitit
- Siguri 24/7

- Standarde të larta dhe bashkëkohore ndërtimi
- Zona më e mirë për qira sipas operatorëve turistikë
- Financim për pronën pa kolateral
- Rritje e vlerës së pronës me kalimin e kohës

- Afër 120 plazheve natyrore
- Pranë monumenteve historike të UNESCO-s
- Kuzhina më e mirë vendase dhe mesdhetare
- Vendndodhje në qendër të qytetit, 10 minuta nga Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës
- Distancë e afërt nga Parku i Sodës
- Pranë Shtëpisë së Pavarësisë
- Koncept i ri jetese pranë një Marine të Klasit Botëror



- 5* Vlora Marriott Hotel
  & Marriott Branded Residences
- Hotel 4* , brand ndërkombëtar
- Dyqane të brandeve ndërkombëtare
- SPA, qendra Wellness
- Pishinë të brendshme
- Ambient për fëmijë dhe zona argëtimi

- Marina e parë shqiptare e klasit botëror
- +400 vende ankorimi
- Klub Jahti
- Shërbime për marinën
- Plazhe publike dhe private
- Koncept i ri jetese brenda dhe pranë një Marine
- Destinacion i ri turistik ndërkombëtar
- Projekt i qëndrueshëm
- Mundësi e shkëlqyer për profesionistët e rinj
- Zonë e rijetëzuar që lidh qytetin
  me një prej pikave të rëndësishme
  si Pylli i Sodës











# Rezidenca

## Vendi që do të bëhet shtëpia juaj

Zgjidhni apartamentin tuaj në Rezidencën Vlora Marina, aty ku horizonti shkrihet me qiellin, rrethuar nga parqet e gjelbëruara dhe bluja e thellë e detit. Një risi arkitektonike, e cila harmonizon traditën dhe trashëgiminë me bashkëkohoren, duke ruajtur gjithmonë vlerat mesdhetare. Vendi ideal për të jetuar dhe për të shijuar një stil të rafinuar jetese me të gjitha shërbimet e një cilësie të lartë, pranë marinës më të madhe në vend.

## Një pamje për t'u shijuar

Jetesa pranë detit në apartamentet premium të Vlora Marina, ofron pamje mahnitëse të detit Adriatik dhe Jon, ishullit të Sazanit dhe gjithë Gjirit të Vlorës. Pozicioni ideal, do t'ju bëjë të ëndërroni, teksa i gëzoheni dhuratave të natyrës që mund t'i kundroni me ëndje nga ballkoni juaj.

- **Apartamente me pamje nga deti**
- **Standarde të larta ndërtimi**
- **Veranda me pamje të plotë**
- **Ambiente të mëdha me shumë hapësirë**
- **Shumëllojshmëri shërbimesh**
- **Parkim për çdo apartament**
- **Hapësirë parkimi shtesë për apartamentet premium**
- **Siguri 24 orë**
- **Akses i drejtpërdrejtë në plazhin privat dhe në park**
- **Akses i drejtpërdrejtë në rrugët kryesore**
- **Shëtitore dhe sunset square**









# Tipologjitë
# e Apartamenteve

## APARTAMENT
## ME NJË DHOMË GJUMI

- Dhomë ndenje + ngrënie
- Dhomë gjumi
- Tualet
- Ballkon
- Verandë




| | |
|---|---|
| **88.9 m²** | Sipërfaqe e brendshme |
| **10.2 m²** | Hapësira të përbashkëta |
| **30.6 m²** | Verandë |

**159.52 m²** **Sipërfaqe totale**




# APARTAMENT ME DY DHOMA GJUMI - LLOJI 1

Dhomë ndenje + ngrënie

Dy dhoma gjumi

Dy tualete

Ballkon

| | |
|---|---|
| **121 m²** | Sipërfaqe e brendshme |
| **13.8 m²** | Hapësira të përbashkëta |
| **134.8 m²** | **Sipërfaqe totale** |

# Tipologjitë e Apartamenteve

## APARTAMENT ME DY DHOMA GJUMI - LLOJI 2

- Dhomë ndenje + ngrënie
- Dy dhoma gjumi
- Dy tualete
- Ballkon




| | |
|---|---|
| **117.66 m²** | Sipërfaqe e brendshme |
| **14.4 m²** | Hapësira të përbashkëta |
| **132.06 m²** | **Sipërfaqe totale** |




# APARTAMENT ME DY DHOMA GJUMI - LLOJI 3

- Dhomë ndenje + ngrënie
- Dy dhoma gjumi
- Dy tualete
- Ballkon
- Verandë

**144 m²** Sipërfaqe e brendshme
**16.4 m²** Hapësira të përbashkëta

**160.4 m²** **Sipërfaqe totale**

# Tipologjitë e Apartamenteve

## APARTAMENT ME TRE DHOMA GJUMI - LLOJI 1

- Dhomë ndenje + ngrënie
- Tre dhoma gjumi
- Dy tualete
- Ballkon
- Verandë
- Gardërobë




| | |
|---|---|
| **155.92 m²** | Sipërfaqe e brendshme |
| **21.57 m²** | Hapësira të përbashkëta |
| **28.52 m²** | Verandë |
| **206.01 m²** | **Sipërfaqe totale** |




# APARTAMENT ME TRE DHOMA GJUMI - LLOJI 2

- Dhomë ndenje + ngrënie
- Tre dhoma gjumi
- Dy tualete
- Ballkon
- Verandë

| | |
|---|---|
| **152.3 m²** | Sipërfaqe e brendshme |
| **17.4 m²** | Hapësira të përbashkëta |
| **30.6 m²** | Verandë |
| **200.3 m²** | **Sipërfaqe totale** |


Bora Kanto
Bora Kanto


JUICEBAR
CAKERIN

# Një shëtitore si askund tjetër

### Gjithçka që mund të keni imagjinuar dhe shumë më tepër

Shëtitorja e Vlora Marina ndodhet në një hapësirë plot gjallëri dhe zonë dinamike, me potencial të jashtëzakonshëm. E shtrirë buzë detit, ajo bashkohet me plazhin 2 km të gjatë, ku ju mund të pushoni pas një ecjeje të këndshme nëpër atraksionet e ndryshme dhe të pafundme përreth.

- **24,500 m2 zonë komerciale**
- **Rreth 19 restorante & bare**
- **Rreth 38 dyqane**
- **Mbi 20 njësi shërbimi**
- **Shërbime ndërkombëtare Wellness dhe kujdesit për veten**
- **Argëtim për fëmijët & familjen**
- **Brande Roof Top & Klube**
- **Pishinë e brendshme**
- **Kazino**
- **5* Vlora Marriott Hotel**
- **Women secret, Geox**
- **Okaidi, Parfois, Carpisa, Aldo shoes**

Dhe shumë të tjera që do të vijnë...




PER HAIR
NASTUZZI
HEAVN

# Një Marinë Unike

Kaloni toka, dete dhe qiej duke e ditur se do të zbarkoni përherë në një port, që do t’ju dhurojë ndjenjën më të mirë në botë. Vlora Marina është pikënisja perfekte për udhëtimin tuaj në Mesdhe, Ballkan dhe plazhet e paprekura të detit Jon dhe Adriatik. Vendi i duhur për të ndaluar pas një udhëtimi të gjatë në det, me kapacitet për të strehuar jahtet dhe super-jahtet deri në 50 metra të gjatë. Një marinë që ofron të gjitha kënaqësitë për një lundrim të qetë, të sigurt dhe relaksues.



**Shërbimet**

- Furnizim me karburant
- Asistencë 24 orë për jahte
- Ankorim për jahte dhe super-jahte
- Shërbim recepsioni
- Klubi i jahteve
- Zyra administrate
- Parkim dhe rrugë e dedikuar
- Siguri 24 orë në breg dhe në det
- Energji elektrike
- Ushqim dhe pije
- +400 vende ankorimi
- Pika e kontrollit kufitar
- Dyqane të ndryshme
- Bare dhe restorante

**Shërbime të tjera**

- Sporte për ekuipazhin
- Plazh privat
- Palestër
- Dhoma e kapitenit



# Hotelet

## Një vend ëndrrash për të qëndruar

Keni menduar ndonjëherë të arratiseni në një vend ku mund të bëheni njësh me qetësinë e detit në një ditë të ngrohtë vere? Të jetoni aventura pafund dhe të zbuloni një kulturë të jashtëzakonshme?

Mikpritja qëndron në themel të vlerave tek Vlora Marina dhe ju do ta ndieni atë në çdo detaj të hoteleve tona. Qetësia buzë detit, do ju bëjë të “zbrazni” zemrën nga çdo shqetësim dhe të bëheni gati për të jetuar një përvojë të plotë.

Vlora Marriott Hotel është hoteli i parë me 5 yje Marriott në bregdetin shqiptar. Ky hotel do të ofrojë ekselencën e shërbimit si për klientët e tij besnikë, ashtu edhe për ata që duan të provojnë më të mirën e një shërbimi premium. Përveç hotelit, Marriott do të sjellë gjithashtu për herë të parë në Shqipëri 150 apartamente të branduara. Marriott International përfshin një portofol prej më shumë se 8,700 pronash nën 31 marka kryesore që përfshijnë 139 vende dhe territore të ndryshme. Ai operon dhe jep ekskluzivitet të menaxhimit të hoteleve në të gjithë botën.

- **SPA, Bare & restorante**
- **Pishinë**
- **Sallë konferencash dhe takimesh**
- **Kazino**
- **Parkim**
- **Pamje panoramike**
- **Rrugë e dedikuar për hyrjen në hotel**
- **Apartamente të branduara**





# Zbuloni larminë e shijeve shqiptare dhe më të mirën e detit që servir kuzhina mesdhetare!







# Më shumë se thjesht një shtëpi

Të jesh pronar i një apartamenti në Vlora Marina do të thotë jo vetëm të bëhesh pjesë e një komuniteti mikpritës ku do të ndihesh si në shtëpi, por edhe të përfitosh nga larmia e shërbimeve.

**Shërbime të mirëmbajtjes dhe sigurisë**

- Mirëmbajtje e hapësirave të përbashkëta
- Mirëmbajtje dhe ndriçim i rrugëve
- Recepsion 24 orë
- Monitorim dhe mbikëqyrje 24 orë me kamera

**Shërbime të dedikuara për rezidentët**

- Pastrim dhe gjelbërim
- Shërbime elektrike dhe hidraulike
- Lavanderi
- Dezinfektim dhe ventilim



# KAPËRCENI TOKA, DETE DHE QIEJ



# Investim i zgjuar

## Timeshare

Ky program unik i pronësisë së përbashkët që ofron ekskluzivisht Vlora Marina, krijon një numër të pafundmë mundësish për pushime pa angazhimin financiar dhe stresin e blerjes së një rezidence të dytë.

## Financimi i Pronës

Falë bashkëpunimit me bankat e ndryshme në Shqipëri, Vlora Marina ofron mundësi financimi pa kolateral, si për rezidentët ashtu edhe për jorezidentët shqiptarë.

## Investim i zgjuar

Vlora Marina është më shumë se një destinacion, është një mundësi unike investimi në një zhvillim të klasit botëror, inovativ dhe të qëndrueshëm.
Pozicionuar në zemër të qytetit të Vlorës, me një panoramë mahnitëse nga deti, ky projekt ekskluziv ofron potencial të lartë fitimi dhe kthim të sigurt të investimit.
Me zhvillimin e shpejtë të infrastrukturës dhe kërkesën e vazhdueshme për akomodim dhe shërbime, Vlora po kthehet në një nga qytetet më të kërkuara për pasuritë e paluajtshme në Mesdhe.



Bregdeti Jon, Shqipëri





# Procesi i blerjes

## Rezervimi

Ju mund të rezervoni pronën tuaj nëpërmjet një marrëveshjeje paraprake, pa detyrimin për të paguar një tarifë fillestare. Një hap i parë i thjeshtë për ta bërë ëndrrën tuaj realitet.

## Para-Shitja

Një ekip i përkushtuar dhe profesionistë është në dispozicion të klientëve për t'i mbështetur ata gjatë këtij procesi dhe për t'i siguruar se po bëjnë zgjedhjen e duhur në përputhje me mundësitë dhe kërkesat e tyre.

## Blerja

Pas procesit të përzgjedhjes dhe rezervimit, hartohet kontrata e blerjes. Kontrata përcakton metodën e blerjes, të drejtat dhe përfitimet bazuar në marrëveshje.

## Akti i pronësisë

Në fund të procesit të ndërtimit dhe pas kryerjes së pagesës së plotë, vijojmë procesin kadastral deri në dorëzimin e certifikatës së pronësisë. Pas blerjes së pronës së re, do të vazhdojmë t'ju ofrojmë të gjithë ndihmën e nevojshme. Prioriteti ynë është të ofrojmë shërbime të shkëlqyera, në mënyrë që të keni një eksperiencë të qetë dhe të këndshme.

# FAQ

## 1. Cilat janë llojet e apartamenteve?

Vlora Marina ofron +800 apartamente dhe 150 janë apartamente të branduara.
Apartamentet kanë tipologji të ndryshme: 1+1, 2+1, 3+1

## 2. Cila është vendndodhja e saktë e projektit?

Adresa: Porti i Vlorës, Skelë

## 3. Kur është planifikuar përfundimi i projektit?

Afati kohor i zhvillimit të projektit i ndarë në disa faza

2027 – D4
2028 – B2, B3, B4, C5
2029 – A1, C2, C3, C4, D3
2030 – B1, C1
2031 – A2, A3, D2

## 4. Çfarë është një apartament i branduar?

Apartamentet e branduara janë zakonisht një partneritet ndërmjet një brandi të njohur dhe një zhvilluesi. Brandi i jep një licensë zhvilluesit për të tregtuar dhe shitur rezidencat që përfshijnë markat e tyre. Ajo që i dallon apartamentet marka nga apartamentet e tjera në rezidencë është shërbimi i ofruar.
*Ky është një përkufizim i përgjithshëm thjesht për qëllime informimi.

## 5. Si do të funksionojë riparimi ose rinovimi i ndërtesës?

Pas dorëzimit të njësisë për kategori të ndryshme punimesh (të cilat do të specifikohen në një moment të dytë), sigurohet një garanci 1-2 vjeçare.

## 6 Çfarë facilitete ka brenda saj Vlora Marina?

Vlora Marina do të përfshijë brenda saj njësi të ndryshme shërbimi si dyqane të brandeve kombëtare dhe ndërkombëtare
Shitje me pakicë 11 (dyqane, brande premium)
Njësi shitje 16
Supermarket 1 (produkte vendase dhe ndërkombëtare)
Elektronikë 1 (markë e njohur)
Shërbime 9
Zona argëtimi 2
Zona argëtimi për fëmijë 5
Wellness SPA 4

## 7. Cilat janë hapat për rezervimin e apartamentit?

Klienti kalon nëpër disa hapa për të rezervuar një njësi. Një prezantim i përgjithshëm i projektit bëhet nga menaxheri ynë i shitjeve, i cili paraqet gjithashtu opsione specifike sipas kërkesave të klientit. Pasi klienti zgjedh njësinë, ai ka mundësinë të negociojë mënyrën e pagesës, ku duhet që të kryhet së paku 30% e vlerës totale të asaj që konsiderohet si kësti i parë. Pas këtij hapi, menaxherët e shitjeve vazhdojnë me rezervimin e njësisë, e cila do të jetë në status rezervimi për një periudhë të caktuar.

Gjatë kësaj periudhe klienti dhe menaxheri i shitjeve përgatisin marrëveshjen, e cila është gati për t'u dërguar tek noteri dhe për t'u nënshkruar nga klienti

## 8. Cila është skema e pagesës ?

30% e shumës së kontratës duhet të paguhet brenda një muaji nga momenti i nënshkrimit të kontratës.
60% e shumës së kontratës do të paguhet sipas fazave të ndërtimit.
10% e shumës së kontratës do të paguhet me njësinë (5,000 € duhet të paguhet pasi akti të lëshohet nga autoriteti përkatës)

## 9. Cilat janë mundësitë për ambiente komerciale të disponueshme në Vlora Marina?

Vlora Marina do të ofrojë një sërë mundësish komerciale për bizneset që kërkojnë të operojnë në zonë. Disa nga mundësitë përfshijnë hapësira për njësi tregtare, restorante, kafene, bare dhe vende argëtimi. Gjithashtu, ka mundësi për bizneset që ofrojnë shërbime të tilla si agjenci udhëtimesh, varka me qira dhe pajisje për sporte ujore me qira. Marina është një destinacion popullor për turistët e huaj dhe vendas, duke u ofruar bizneseve trafik të mjaftueshëm klientësh potencialë.

## 10. Cilat brande gjejmë tek Vlora Marina?

Brandet e para pjesë e Vlora Marina përmenden më poshtë, ashtu si edhe shumë të tjera që do të vijnë dhe do të jenë pjesë e komunitetit premium të markave që do të mirëpresë Vlora Marina.
**Brandet e shitjeve me pakicë si:** Women'Secret, Parfois, Geox, Okaidi, Carpisa, Aldo.

## 11. Cilat janë avantazhet ose përfitimet e të pasurit një njësi komerciale në Vlora Marina?

Vendndodhja kyçe: Vlora Marina ndodhet në një pozicion strategjik në Rivierën shqiptare, me akses të lehtë në plazhet dhe atraksionet përreth. Kjo e bën atë një destinacion ideal për turistët e huaj dhe shqiptarë.
Qendër tregtare dinamike: Marina është një qendër tregtare plot gjallëri, me një larmi biznesesh që operojnë në zonë. Kjo ofron mundësi të pafundme për krijim kontaktesh dhe lidhjesh, promovim të ndërsjellë dhe bashkëpunim.
Ekonomia në rritje: Ekonomia e Shqipërisë ka shënuar rritje të qëndrueshme në vitet e fundit, duke e bërë atë një destinacion tërheqës për bizneset që synojnë të zgjerohen në tregje të reja.

## 12. Cilat janë disa nga veçoritë unike që ofron Vlora Marina?

Teknologjia e fundit: Vlora Marina siguron pajisje moderne si siguri 24/7, internet me shpejtësi të lartë, furnizim me energji elektrike, ujë, dushe, shërbime lavanderie, parking, karburant, asistencë teknike dhe menaxhim mbetjesh.
Vende ankorimi: Marina ka +400 vend-ankorimi që mund të strehojnë jahte deri në 50 metra të gjatë.
Miqësore ndaj mjedisit: Marina është zhvilluar duke patur në fokus të qenit miqësor me natyrën, nëpërmjet përdorimit të sistemeve të ndriçimit me eficencë energjie dhe sistemit të menaxhimit të mbetjeve.
Ngjarje kulturore dhe argëtuese: Marina do të mirëpres një sërë ngjarjesh kulturore dhe argëtuese gjatë gjithë vitit, duke përfshirë koncerte, ekspozita arti dhe shfaqje ndërkombëtare me jahtet.

## 13. Pse një klient duhet të investojë për të blerë një apartament në Vlora Marina?

Pozicioni strategjik: Vlora Marina është një portë e hapur, e vendosur në një qytet modern, i cili rrethohet nga dy dete, ai Adriatik dhe deti Jon. Afërsia që do të ketë me Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës dhe tunelin e Llogarasë do ta pasurojë qytetin me më shumë turistë.
Mënyrë jetese e rafinuar: Vendndodhja u siguron apartamenteve një pamje të bukur nga deti, me sipërfaqe të mëdha dhe veranda të hapura.
- Çdo ndërtesë do të ketë një pritje në katin e parë kushtuar rezidentëve.
- Cilësia e ndërtimit në residence është e standardeve të larta.
- Projekti ofron siguri 24 orë, shërbime dhe aktivitete të ndryshme për banorët e tij.

Financimi i pronës: Në bashkëpunim me banka të përzgjedhura në Shqipëri, Vlora Marina ofron mundësi financimi pa kolateral për rezidentët dhe jorezidentët në Shqipëri.





Ishulli i Zvërnecit







Vjosa, lumi i fundit i egër në Evropë

# Investitorët tanë

BRUNES CONSTRUCTION, një zhvillues i konsoliduar i projekteve të njohura të ndërtimit në Shqipëri.

E themeluar në vitin 1994 nga Z. Geront Çela dhe Bledar Çela, kompania importon dhe eksporton pllaka, sanitare, mallra dhe mobilje të ndryshme.

Operon me 8 dyqane në të gjithë vendin. Brunes Group ka në pronësi DEKOLL, PintoCOLOR dhe TERMAX.
Grupi ka të punësuar rreth 670 persona, përkushtimi dhe pasioni i të cilëve mbetet çelësi i historisë dhe suksesit të tij.

# Partner

## BALFIN REAL ESTATE

Balfin Real Estate është kompania inovatore ne tregun e Real Estate në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut e Zvicër, e cila ofron shërbime 360 gradë në këtë industri, duke ju siguruar kështu bleërsve e partnerëve një eksperiencë të plotë dhe efikase . Balfin Real Estate pjesë e Grupit Balfin, menaxhon mbi 25 projekte që prej vitit 2018 dhe një nga portofolët e pronave më të larmishëm që nga pronat premium në zonat bregdetare, tek ato elitë, apo mass market në qytetet kryesore të Shqipërisë.

**Tiranë**
Bulevardi "Bajram Curri",
Qendra e Biznesit ETC, kati i 8-të,
njësia 131-134, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 69 801 4999
e-mail: sales@balfinrealestate.com

**Zyrih**
Seefeldstrasse 287, 8008 Zyrih, Zvicër

**Shkup**
Rruga "Nikola Vapcarov", nr. 12, Shkup,
Republika e Maqedonisë së Veriut

**Prishtinë**
Rruga "Rexhep Luci", hyrja 19, nr. 4,
Prishtinë, Kosovë

**Vjenë**
Schwarzenbergstraße 1-3/4 1010, Wien, Austria

**New York**
1151, Broadway, New York

## BALFIN DEVELOPMENT

BALFIN Development është një nga kompanitë kryesore investuese në zhvillimin e projekteve në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit. Historia e suksesit të kësaj kompanie përfshin zhvillimin e disa prej projekteve më të mëdha në Shqipëri duke ofruar suport që në fazat fillestare. Me një portofol të gjerë projektesh rezidenciale, turistike, industriale e komerciale, BALFIN Development ka vendosur standardet e tregut duke përmirësuar ndjeshëm stilin e jetesës në komunitet.

**Tiranë**
"Tish Daija", KIKA 2 Rezidence,
godina no.3, kati i 8-të, Tiranë, Shqipëri
info@balfindevelopment.al

# Partner

D Marin

D-Marin është rrjeti ndërkombëtar i menaxhimit të marinave në të gjithë Mesdheun dhe Lindjen e Mesme. Me një eksperiencë mbi 20 vjeçare D-Marin është përkushtuar për të ofruar një shërbim premium në menaxhimin dhe zhvillimin e marinës, duke ofruar përvoja të dalluara për klientët dhe standarde të jashtëzakonshme të cilësisë për partnerët e biznesit.

MARRIOTT

Prezente në treg që prej vitit 1993, Marriott International, Inc. konsiderohet sot një kompani lider që operon, jep ekskluzivitet dhe licencon markat e akomodimit si prona hoteliere dhe rezidenciale. Marriott zotëron një portofol të pasur me mbi 31 brande dhe rreth 8700 prona në 139 vende të ndryshme të botës, ndërsa dallon për ekselencë në shërbime premium me një kujdes të shtuar ndaj klientëve në të gjithë botën.

BALFIN
ASSET
MANAGEMENT
& HOSPITALITY

E themeluar në vitin 2023, Balfin Asset Management & Hospitality është e specializuar në optimizimin e aseteve të mikpritjes për rritjen e përfitimit dhe vlerës së tregut. Falë një filozofie inovatore BAM ka arritur të shkrijë në mënyrë perfekte asetet dhe bukuritë natyrore të vendit me shërbime premium dhe të klasit botëror, duke vendosur standarde të reja në këtë industri.



VLORA MARINA

www.vloramarina.com

vlora_marina

Vlora Marina

+355 69 801 4999

sales@vloramarina.com

Sea Port, Vlora, Albania

VLORA MARINA



# FRYMEZUAR NGA

# DETI